

PROKURIMI
1223-19-12-23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4882

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 18/12/2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.124

Datë: 12.12.2023

“ Për dhënien e ndihmës financiare familjes Markja”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me urdhër dhe Porosi

P/Sekretariati

Sara Karaj



4882/19/12/23
Mbrojtja e Mbrojtjes

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1223/1 prot.

Peshkopi, më 19.12.2023

Lënda : Për vendimin nr.124, datë 12.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.124, datë 12.12.2023 "*Për dhënien e ndihmës financiare familjes Markja*", konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje, veprim që kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqet për miratim projekt akte të kësaj natyre.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

P R E F E K T I

Nexhbedin SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 124 Datë 12/12/2023

“Për dhenien e ndihmës financiare familjes Markja”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.84/2022“Për buxhetin e vitit 2023”, në zbatim të uxhetit të bashkisë Dibër ,i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22/12/2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.19/1 prot. datë 11/01/2023, i ndryshuar: me propozim të administratorit të njesise administrative Maqellare,Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **12.12.2023**, me 16 vota pro, 0 kundër dhe 11 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e ndihmës financiare nga fondi rezerve **znj.Yllka Markja**,bashkeshortja e te ndjerit **z.Bedri Markja** i cili nderroi jete pas nje aksidenti ne pune duke lene pas bashkeshorten dhe shtate femije. Ndihma financiare do të jepet në vlerën **200.000** (dyqindmijë) lekë.
Të pakësohet :
Gr. 00 Tit.1810 Kap.1 Art.604 200.000 lekë
Të shtohet:
Gr. 00 Tit. 1110 Kap. 1 Art. 604 200.000 lekë.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **12.12.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak
Irimi Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës
PROJEKTVENDIM

Nr. 29 Datë 01/12/2023

“Për dhënien e ndihmës financiare familjes Markja ”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.84/2022“Për buxhetin e vitit 2023”, në zbatim të uxhetit të bashkisë Dibër ,i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22/12/2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.19/1 prot. datë 11/01/2023, i ndryshuar: me propozim të administratorit te njesise administrative Maqellare :

KËRKOJMË:

I. Miratimin e ndihmës financiare nga fondi rezerve znj.Yllka Markja,bashkeshortja e te ndjerit Bedri Markja i cili ndërroi jete pas nje aksidenti ne pune duke lene pas bashkeshorten dhe shtate femije. Ndihma financiare do të jepet në vlerën **200.000** (dyqindmijë) lekë.

Të Pakësohet:

Gr. 00 Tit. 1810 Kap.1 Art. 604 200.000 lekë

Të Shtohet:

Gr.00 Tit. 1110 Kap. 1 Art. 604 200.000 lekë

II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Dibër.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR :

Drejtor Juridik
Ismet SARACI

Drejtor Ekonomik
Çeljeta ZUNA

Përgjegjës finance
Antike TORBA

KRYETARI

Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me porosi

Nënkryetari bashkisë

Ruzhdi DEDA